

## **E DREJTA E INFORMIMIT SI NJË E DREJTË THEMELORE E NJERIUT**

E drejta e informimit është pranuar si një mjet i rëndësishëm dhe i nevojshëm për përfundimin e mëtejshëm të demokracisë dhe për hapjen maksimale të qeverisë ndaj qytetarëve. Aksesit i lirë ndaj informacionit luan një rol kyç në promovimin e transparencës dhe në parandalimin e korrupsionit dhe, si i tillë, institucionet shtetërore duhet ta ofrojnë atë në kohë dhe në mënyrë të plotë për qytetarët, me qëllim që të garantojnë një përdorim sa më efektiv të tij. Gadishmëria në dhënien e informacionit nga institucionet e administratës publike rrit përgjegjshmërinë e tyre në shërbimin ndaj qytetarëve duke nxitur në këtë mënyrë transparencën e autoriteteve publike dhe respektimin e ligjit.

Transparenca nënkupton ndarjen e informacionit si edhe ushtrimin e veprimtarisë së institucioneve në mënyrë të hapur me publikun. Çelsi i një qeverisje të mirë është ndërtimi i ure komunikimi midis qytetarëve dhe autoriteteve publike, duke krijuar kështu një qeverisje të hapur dhe në shërbim të interesave të publikut. Një qeverisje e mirë përbën kusht prandalues për zhvillimin e korrupsionit uljen e mundësisë për abuzim me qeverisjen ndërkohë, nga ana tjetër, rrit përgjegjshmërinë e institucioneve publike ndaj publikut, i ofron shërbimin e duhur publikut dhe garanton zbatimin e të drejtave të njeriut.

E drejta e informimit është një e drejtë njerëzore e njohur botërisht. Megjithatë, ashtu si ndodh me çdo të drejtë tjetër, duhet të jetë e balancuar dhe e kufizuar në disa aspekte, me qëllim që të garantohet mbrojtja e të drejtave të tjera dhe të shmangen konfliktet. E drejta themelore për akses të informacionit publik garantohej nga një sërë aktesh kombëtare dhe ndërkombëtare siç janë:

1. Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut në nenin 19 përcakton:<sup>1</sup>

*“Të gjithë kanë të drejtën e lirisë së mendimit dhe shprehjes; kjo e drejtë përfshin lirinë për të pasur opinione pa ndërhyrje dhe të kërkojë, marrësh dhe japësh informacion dhe mendime nëpërmjet çdo medie, pavarësisht kufijve.*

2. Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut në nenin 10 përcakton:<sup>2</sup>

*“Çdokush ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit dhe lirinë për të marrë ose për të dhënë informacione dhe ide pa ndërhyrjen e autoriteteve publike dhe pa marrë parasysh kufijtë. Ky nen nuk i ndalon Shtetet që të kërkojnë licencimin e ndërmarrjeve të transmetimit audio, kinematografik ose televiziv.”*

Ndërkohë, përveç akteve ndërkombëtare, e Drejta e Informimit është e njohur edhe e mbrojtur edhe në aktet ligjore të brendshme në Republikën e Shqipërisë.

<sup>1</sup> Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, neni 19, 4.

<sup>2</sup> Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut, neni 10.

Më konkretisht, akti themeltar i shtetit shqiptar, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, në nenin 23 përmendë që:<sup>3</sup> 1. *E drejta e informimit është e garantuar.* 2. *Kushdo ka të drejtë, në përputhje me ligjin, të marrë informacion për veprimtarinë e organeve shtetërore, si dhe të personave që ushtrjnë funksione shtetërore.* 3. *Kujtdo i jepet mundësia të ndjekë mbledhjet e organeve të zgjedhura kolektive.*

Përveç parashikimeve kushtetuese kjo e drejtë trajtohet me gjerë në ligjin nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”. Sipas këtij ligji, “çdo person ka të drejtën e njohjes me informacionin publik, pa qënë i detyruar që të shpjegojë arsyet apo motivet”. Por çfarë informacioni mund të kërkojë çdo individ? Çdo individ<sup>4</sup> ka të drejtë që të kërkojë:

- informacionet publike<sup>5</sup> që lidhen me veprimtarinë e organeve shtetërore;
- si edhe të **personave që kryejnë funksione shtetërore**;
- **pa shpjeguar motivin** e kërkesës së tij.

Kërkesa që bën kërkuesi duhet të bëhet me shkrim dhe dërgohet dorazi, me postë ose me postë elektronike. Kërkesa duhet të:

- përmbajë emrin dhe mbiemrin e kërkuetit;
- të përmbajë adresën postare ose elektronike ku kërkohet të dërgohet informacioni;
- jetë e qartëdhe të përshkruajë saktë informacionin që kërkohet;
- forma klasike e kërkesës është me shkrim.

Pasi depozitohet kërkesa në institucionin përkatës, regjistrohet në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve. Autoriteti publik ka detyrimin që të japi informacionin duke vënë në dispozicion të kërkuetit kopje të dokumentit të kërkuar më përjashtim të rasteve kur ligji e ndalon dhënien e informacionit.

## I. Veprimet e Autoritetit Publik

Veprimet që kryen autoriteti publik pasi regjistron kërkesën janë:

1. Në rast se AP është i paqartë në lidhje me përmbajtjen dhe natyrën e kërkesës, kontakton menjëherë e jo më vonë se 48 orë nga paraqitja e kërkesës me kërkuetin, për të bërë sqarimet e nevojshme.
2. Në rast se pas shqyrtimit të kërkesës AP konstaton se nuk e zotëron informacionin e kërkuar, i dërgon jo më vonë se 10 ditë kalendrike nga data e dorëzimit të kërkesës autoritetit kompetent, duke vendosur në djeni edhe kërkuetin.
3. Në rastin e informacioneve të klasifikuara “sekret shtetëror” AP të cilit i është drejtuar kërkesa për informacion, fillon menjëherë procedurën e rishikimit të klasifikimit. Njoftohet kërkuesi dhe shtyhet afati për dhënien e informacionit brenda 30 ditëve punë.

<sup>3</sup> Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 23.

<sup>4</sup> Çdo individ nënkupton qofte person fizik ose juridik shqiptar ose i huaj.

<sup>5</sup> Informacion publik - çdo e dhënë e regjistruar në çfarë do lloj forme apo formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik, pavarishtë nëse është përpiluar ose jo nga autoiteti publik.

4. AP trajton kërkesën për informim dhe vë në dispozicion informacionin e kërkuar jo më vonë se 10 ditë pune nga dita e dorëzimit të saj.

Siç mund të vëmë re ligji përcakton një afat 10 ditor për kthimin e përgjigjes dhe vënien në dispozicion të informacionit ndaj kërkuarit. Në rast se kalohet afati 10 ditor atëherë do të ndodhemi përpara **refuzimit të informacionit**. Kërkuarit i cili çmon se i janë shkelur të drejtat e parashikuara nga ligji nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” ka të drejtë që të ankohet në rrugë administrative pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrotjen e të Dhënave Personale.

Ankuesi mund t'i drejtohet KDIMDHP brenda 30 ditëve pune nga dita kur:

- Ankuesi ka marrë njoftim për refuzimin e informacionit
- Ka kaluar afati I parashikuara në ligj për dhënien e informacionit.

Komisioneri pasi merr ankesën ia kalon strukturës përkatëse për trajtim dhe brenda 15 ditëve pune nga dita e dorëzimit merr vendim për:

1. Mospranim të ankesës;
2. Pranimin e kërkesës dhe urdhërimin e Autoritetit Publik për të dhënë informacionin e kërkuar;
3. Sanksionimin e kundravajtjeve administrative.

## II. Shkeljet administrative

Ligji nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” përcakton shkeljet dhe sanksionet administrative. Do të konsidorehen shkelje administrative në përputhje me këtë ligje:

1. refuzimi i dhënies së informacionit,
2. mosvënien në zbatim e programit institucional të transparencës, brenda afatit të parashikuara,
3. mosrishikimi i programit institucional të transparencës,
4. moskrijimi, mosmbajtja, mospublikimi apo mospërditësimi i Regjistrit të Kërkesave dhe Përgjigjeve,
5. mosplotësimi i kërkesave për informacione, të regjistruara në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve,
6. mosregjistrimi i kërkesës për informim, mosaktimi i një numri rendor për të dhe mosdhënien e të dhënave të kontaktit të koordinatorit për të drejtën e informimit,
7. mosdërgimi i kërkesës për informim te një autoritet tjetër publik,
8. mosnjoftimi i kërkuarit se kërkesa e tij është dërguar një autoriteti tjetër dhe kontaktet e nevojshme i janë dërguar autoritetit tjetër,
9. mospërcaktimi paraprakisht i një tarife, mospublikimi, ose aktimi i tarifave abuzive për riprodhimin dhe dërgimin e informacionit,
10. mosnjoftimi i kërkuarit për vendimin për zgjatjen e afatit për plotësimin e kërkesës për informim,
11. dëmtimi ose shkatërrimi i dokumenteve zyrtare, me qëllim shmangien e së drejtës për informim,

12. moszbardhja e dokumenteve zyrtare, në kundërshtim me rregullat në fuqi, me qëllim pengimin e ushtrimit të së drejtës për informim.

Këto shkelje mund të konstatohen nga Komisioneri, të cilit i lind e drejta sipas ligjit për të drejtën e informimit të vendosë edhe sanksionin përkatës për shkeljen e kryer nga Autoriteti Publik. Në rast se komisioneri nuk vepron brenda afatit 15 ditor të dorëzimit të ankesës, atëherë subjektit i lind e drejta ti drejtohet gjykatës.

### **III. Detyrimet e Autoritetit Publik**

Ligji nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” parashikon disa detyrime për Autoritetin Publik në mënyrë që të kemi një zbatueshmëri të këtij ligji por gjithashtu që të sigurohet mbrotja e të drejtës së informimit. Fillimit le të përcaktojmë se çfarë do konsiderohet “Autoritet Publik”<sup>6</sup>. Autoriteti Publik është :

- çdo organ administrativ i parashikuar në legjislacionin në fuqi për procedurat administrative,
- organet ligjvënese,
- organet gjyqësore,
- organet e prokurorisë së çdo niveli,
- organet e qeverisjes vendore të çdo niveli,
- organet shtetërore dhe entet publike të krijuara me Kushtetutë ose me ligj,
- shoqëritë tregëtare ku shteti ushtron shumicën e aksioneve,apo që ushtrojnë funksione publike
- çdo person fizik ose juridik të cilit i është dhënë me ligj e drejta e ushtrimit të funksioneve publike.

Pasi përcaktuam se kush bën pjesë në konceptin e Autoriteti Publik po rendisim detyrimet që rrjedhin nga ligji për autoritetin publik.

1. Autoriteti Publik ka detyrimin të informojë kërkuesin për kërkesën e paraqitur prej tij.
2. AP jo më vonë se 6 muaj nga hyrja në fuqi e këtij ligji ve në zbatim Programin e Transparencës, ku përcaktohen kategoritë e informacionit që bëhen publik pa kërkesë, mënyra e bërjes publike.
3. AP rishikon jo më vonë se 5 vjet programin e transparencës.
4. AP krijon, mban dhe bën publike një regjistër të posaçëm për kërkesat dhe informacionet e dhëna në përgjigje të tyre.
5. AP cakton kordinatorin për të drejtën e informimit.

### **IV. Kompetencat e Koordinatorit për të drejtën e informimit**

Risi e ligjit nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” është jo vetëm krijimi i programit të transparencës por gjithashtu edhe vendosja e koordinatorit për të drejtën e informimit. Koordinatorin për të drejtën e informimit ushtron kompetencat e mëposhtme:

<sup>6</sup> Ligji nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit” neni 2 pika 1, 1.

- a) i mundëson çdo kërkuesi të drejtën për t'u njohur me informacionin publik, duke u konsultuar me dokumentin origjinal ose duke marrë një kopje të tij;
- b) krijon, mban, publikon dhe përditëson regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve brenda afatit të parashikuar në ligj;
- c) bashkërendon punën për plotësimin e kërkesave për informacione brenda afateve dhe sipas mënyrës së parashikuar në ligj;
- ç) regjistron kërkesat për informacion dhe cakton një numër rendor për secilën prej tyre;
- d) dërgon kërkesën për informim te një autoritet tjetër publik, brenda afateve të parashikuara në ligj, kur rezulton se autoriteti publik ku është depozituar kërkesa nuk e zotëron informacionin e kërkuar;
- dh) verifikon rastet për dhënien falas të informacionit qytetarëve

Parimi bazë është për shërbimet që ofron administrate publike ndaj publikut janë falas. Sigurisht për të ulur kostot për autoritet publike, ka raste që për ofrimin e shërbimeve të vendoset një tarifë e përcaktuar. Informacioni që i jepet kërkuesit mund ti bashkëngjitet tarifë për:

1. Koston e riprodhimit ,
2. Koston e dërgimit të informacionit.

Informacionet që dërgohen elektronikisht janë falas, ndërkohë për sa i përket tarifave bëhen publike dhe konsultohen here pas here nga KMDIDHP në bashkëpunim me Ministrinë e Finacave.

## V. Kufizimi i të drejtës së informimit

Natyrisht, e drejta e informimit nuk është e pakufizuar në asnjë vend. Përjashtimet e respektimit të kësaj të drejte zakonisht përfshijnë mbrojtjen e sigurisë kombëtare, jetën private, interesat tregtare, rendin publik, informacionin e marrë në mirëbesim, si dhe diskutimet e brendshme të autoriteteve publike. Në rastin e aksesit në informacion, aktet për lirinë e informimit barazpeshohen ose kufizohen me ligje për **informacionin e klasifikuar** dhe ligje për **mbrojtjen e të dhënave personale**. Klasifikimi, posedimi, shpërndarja dhe deklasifikimi i sekreteveshtetërore është rregulluar nga Ligji i Informacionit të Klasifikuar si SekretShtetëror, të miratuar në shkurt 1999 dhe të amenduar në maj 2006. Në varësi të llojit të informacionit, ligji i ndryshuar ravigjëzon katërnivele rëndësie të informacionit të klasifikuar<sup>7</sup>:

- i kufizuar: dhënia e paautorizuar mund të dëmtojë veprimtarinë ose efikasitetin e organeve shtetërore në fushën e sigurisë kombëtare;
- konfidenciale: dhënia e paautorizuar mund të dëmtojë sigurinë kombëtare;
- sekrete: dhënia e paautorizuar mund të rrezikojë shumë sigurinë kombëtare;
- shumë sekrete: dhënia e paautorizuar mund të rrezikojë jashtëzakonisht shumë sigurinë kombëtare.

<sup>7</sup> Ligji nr. 8457 "Për Informacionin e Klasifikuar Sekret Shtetëror," 11.02.1999, më tej i quajtur "Ligji i Informacionit të Klasifikuar." Neni 4, 2.

E drejta e informimit nuk refuzohet automatikisht kur informacioni i kërkuar gjendet në dokumente të klasifikuara “sekret shtetëror”. Në këtë rast, autoriteti publik, të cilit i është dërguar kërkesa për informim, fillon menjëherë procedurën e rishikimit të klasifikimit pranë autoritetit publik që ka urdhëruar klasifikimin, sipas ligjit nr. 8457, datë 11.2.1999, “Për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror””, të ndryshuar. Autoriteti publik njofton menjëherë kërkesuesin për fillimin e procedurës për rishikimin e klasifikimit, sipas ligjit, dhe vendos shtyrjen e afatit për dhënien e informacionit brenda 30 ditëve pune. Në çdo rast, vendimi për trajtimin ose jo të kërkesës për informim merret dhe arsyetohet në bazë të ligjit<sup>8</sup>.

Raste të tjera kur kufizohet e drejta e informimit vijnë si më poshtë:

- E drejta e informimit kufizohet, nëse është e domosdoshme, proporcionale dhe në qoftë se përhapja e informacionit do të shkelte sekretin profesional të garantuar nga ligji.
- E drejta e informimit kufizohet edhe kur, pavarësisht nga ndihma e dhënë nga autoriteti publik, kërkesa mbetet e paqartë dhe bëhet i pamundur identifikimi i informacionit të kërkuar
- E drejta e informimit kufizohet në rast se është e domosdoshme, proporcionale dhe nëse dhënia e informacionit shkakton një dëm të qartë dhe të rëndë ndaj interesave të mëposhtëm:
  - a) sigurinë kombëtare, sipas përkufizimit të bërë nga legjislacioni për informacionin e klasifikuar;
  - b) parandalimin, hetimin dhe ndjekjen e veprave penale;
  - c) mbarëvajtjen e hetimit administrativ në kuadër të një procedimi disiplinor;
  - ç) mbarëvajtjen e procedurave të inspektimit dhe auditimit të autoriteteve publike;
  - d) formulimin e politikave monetare dhe fiskale të shtetit;
  - dh) barazinë e palëve në një proces gjyqësor dhe mbarëvajtjen e procesit gjyqësor;
  - e) këshillimin dhe diskutimin paraprak brenda ose midis autoriteteve publike për zhvillimin e politikave publike;

Sigurisht kufizimet e përmendura më sipër në pikat a, b, c, ç, dh, e, informacioni i kërkuar nuk refuzohet në rast se ekziston një interes publik më i lartë për dhënien e tij.

## VI. Përfundime

Parimi bazë i ligjeve për të drejtën e informimit në botë është se qytetarët kanë të drejtë të kërkojnë materiale që i kanë autoritetet publike. Përcaktimi i dokumenteve dhe materialeve që mund të kërkohen ndryshon nga vendi në vend, por mundësia për t'i marrë këto materialenga autoritetet mbetet i njëjti. Një tjetër parim bazë është që qytetarët nuk janë të detyruar të motivojnë kërkesën për materialet që duan. Gjithashtu, në disa vende e drejta e informimit i njihet jo vetëm qytetarëve vendas, po kujtdo qëkërkon informacion. Çdo kërkesë për

<sup>8</sup> Ligji nr.119/2014 Për të drejtën e informimit, neni 17 pika 5 dhe 6, 9.

informacion duhet të trajtohet më panashmëri, profesionalizëm, duke i dhënë mundësi publikut që të informohet.

Autoriteti publik duhet të krijojë të gjitha mekanizat e nevojshme në mënyrë që të respektohet e drejta e informimit, sepse vetëm në këtë mënyrë krijohet një qeverisje transparente dhe në shërbim të publikut.

Transparenca dhe e drejta e informacionit publik janë elemente kyç në një shoqëri demokratike dhe shërbejnë për t'i dhënë medias, shoqërisë civile, dhe institucioneve të tjera të interesuara mjete për të analizuar se si menaxhohen pushteti dhe burimet e shtetit.

## **Bibliografi:**

### Ligje

1. Ligji nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
2. Ligji nr. 8457 “Për Informacionin e Klasifikuar Sekret Shtetëror,” 11.02.1999.  
Libra
3. Qendra “Res Publica”, “Komentari i ligjit nr.119/2014 për të drejtën e informimit”, Expo Vision Albania, Tiranë, Shtator 2014.
4. Qendra “Res Publica”, “Liria e Shprehjes nga teoria në praktikë”, Expo Vision Albania, Tiranë, Janar 2013.
5. Qendra “Res Publica”, “Studim mbi efektvitetin e ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit” krahasuar me vitet 2013 dhe 2015”, Expo Vision Albania, Tiranë, Dhjetor 2016.

## **WEB**

6. <http://edition.cnn.com/2009/POLITICS/01/30/illinois.governor.quinn/>.
7. [http://www.idp.al/wp-content/uploads/2016/10/Kerkesa\\_per\\_informacion\\_public.pdf](http://www.idp.al/wp-content/uploads/2016/10/Kerkesa_per_informacion_public.pdf)
8. [http://www.idp.al/wp-content/uploads/2017/03/E\\_drejta\\_per\\_informim-Procedura\\_e\\_ankimit.pdf](http://www.idp.al/wp-content/uploads/2017/03/E_drejta_per_informim-Procedura_e_ankimit.pdf)
9. [http://www.idp.al/wp-content/uploads/2016/10/fletepalosje\\_per\\_te\\_njohur\\_ligjin\\_per\\_te\\_drejtjen\\_e\\_informimit.pdf](http://www.idp.al/wp-content/uploads/2016/10/fletepalosje_per_te_njohur_ligjin_per_te_drejtjen_e_informimit.pdf)
10. [http://www.idp.al/wp-content/uploads/2016/10/PyetShtetinAL\\_Leaflet\\_FINAL.pdf](http://www.idp.al/wp-content/uploads/2016/10/PyetShtetinAL_Leaflet_FINAL.pdf)
11. <http://tia.al/wp-content/uploads/2013/11/foiOk.pdf>
12. <http://www.infocip.org/al/wp-content/uploads/2017/05/raport-special-koordinatori.pdf>
13. <http://njohligjin.al/informimi-publik/e-drejta-per-informim/>